



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 1 korrik 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-I-

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Synavere Rysha, Ali Sadriu, Naim Fetahu, Hajdar Beqa dhe Abdyl Ymeri.

Munguan: Bali Muharremaj, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ- i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: z. Raif Preteni, drejtor dhe Ramiz Krasniqi nga ARRU, z. Arsim Bajrami, ministër, Haki Sfishta, Faton Fetahu, Petrit Kelmendi dhe Veton Alihajdari nga MASHT, Artan Venhari, Mirlinda Ahmeti, Qendresa Mulaj, Fexhrie Bogi, Drilon Shala, Mirlinda Beqiri dhe Zukë Zuka nga ZKA.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.06.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, i ftuar z. Raif Preteni, drejtor;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të performances Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore, i ftuar z. Arsim Bajrami, ministër;
5. Rishikimi i planit vjetor të punës dhe planit financiar të KMFP-së, të vitit 2016;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.6.2016

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.6.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Faton Topalli, kryetar, theksoi se në këtë pikë kemi të bëjmë me shqyrtimin e raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të ZRRUK- ut për vitin 2015, i ftuar është drejtori i Zyrës, z. Raif Preteni, me këtë e hapi diskutimin.

Ibrahim Gylderen, ZKA, tha se ne kemi bërë auditimin e PVF-ve të ZRRUK- ut për vitin 2015 dhe se opinionin e këtij auditimi është i kualifikuar. Kjo për faktin se në dy raste ka pasur shkelje të procedurave, për më konkret arsyetimin e jep auditori që e ka udhëhequr ekipin e auditimit.

Zukë Zuka, ZKA, shtoi se sipas opinionit tonë për vitin 2015 Pasqyrat Vjetore Financiare prezantonin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveç keq klasifikimit të shpenzimit për investime kapitale në vlerë prej 3,600€ dhe pagesës së dyfishtë prej 3,397 €. ZRRUK ka blerë antivirus për 25 kompjuterë në vlerë totale prej 3,600€, investim ky i cili është paguar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve pasi ZRRUK nuk ka të buxhetuara mjete financiare në kategorinë e Investimeve Kapitale. Kjo pasuri në fund të vitit është regjistruar si pasuri kapitale në regjistrat e SIMFK-së. Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të ZRRUK-ut ka rezultuar në tre rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit për vitin 2015, një rekomandim është adresuar plotësisht, një pjesërisht dhe një nuk është implementuar ende. Plani për implementimin e rekomandimeve ishte përgatitur dhe dërguar nga ZRRUK-u.

Ali Sadriu theksoi se mungesa e drejtorit Ekzekutiv të ZRRUK- ut, për një kohë të gjatë, ka reflektuar me mangësi e konstatuara nga Auditorët e ZKA në PVF-të e vitin 2015. Disa nga të gjeturat janë nga pakujdesia e zyrtarëve, që mund të themi se janë gabime njerëzore. Këtu mendoj se kishte me qenë të bëhet ndonjë auditim i performancës.

Raif Preteni theksoi se ZRRUK, vitin e kaluar e ka pasur mungesën e drejtorit Ekzekutiv, për shkak të kalimit të mandatit të drejtorit dhe vonesat nga Kuvendi për Zgjedhjen e tij. Kjo në fakt ka paraqitur edhe pengesa në mbarëvajtjen e punës së vetë zyrës. Ne, si zyre kemi përgatitur planin e veprimit nga rekomandimet e ZKA- së dhe të njëjtin jemi në proces të implementimit. Megjithatë për të gjitha të gjeturat ne jemi pajtuar. Ne me Ligjin e ri kemi një emër tjetër, jo si

ZRRUK, po si ARRU. Përmendën të gjeturat individualisht dhe hapat e ndërmarr nga ARRU për implementim të tyre, më hollësisht të dhënat janë në raport të auditimit të ARRU-së për vitin 2015.

Abdyl Ymeri theksoi se gjatë analizimit të raportit të auditimit për ZRRUK për vitin 2015, kam vërejtur se ka pasur lëshime nga më të ndryshme, këtë e tregon edhe opinionimi i raportit. Duke krahasuar me vitin paraprak vërehet se rekomandimet janë zbatuar me kohë. Vlen të theksohet se e gjetura që ka të bëjë me keq klasifikimet e shpenzimeve për blerjen e antivirusëve. Po ashtu pagesat e dyfishtë është bërë, mirëpo kjo le të kuptohet se nuk ka pasur një kontroll të mirëfilltë nga ana e menaxhmentit. Cili është veprimi i drejtorit Ekzekutiv në këtë çështje?

Synavere Rysha tha se ky raport ka paraqitur gjendjen reale të PVF-ve të kësaj Zyre për vitin 2015. Këtë e tregon më së miri opinionimi i Auditimit. Problem në vete ishte mos zgjedhja e drejtorit Ekzekutiv dhe e zëvendësit të tij. Një çështje tjetër janë pagat e ZRRUK-së të cilat janë të paraqitura në raport, si dhe pagesat e dyfishta, siç ka ndodhur me pagesën e shumës prej 3,397 euro për botimin e Raportit Vjetor të Punës së ZRRUK. Për çështjet e ngritura do të kërkoja sqarim nga drejtori i ZRRUK-ut?

Hajdar Beqa tha se raporti i Auditimit është i përpiluar mjaft mirë, ndërsa sa i përket të gjeturave janë për nga natyra e shkeljeve jo të nivelit të lartë. Problemi i pozitës së drejtorit Ekzekutiv të ZRRUK-ut si e zbrazët për një kohë të gjatë nuk ka të bëjë me të drejtat dhe përgjegjësi që i takojnë këtij Institucioni. Kjo është përgjegjësi e Qeverisë së bashku me Kuvendin. Cilët hapa ka ndërmarrë menaxhmenti tani në kontest të adresimit të rekomandimeve nga të gjeturat e raportit të Auditimit?

Faton Topalli shtoi se bazuar në raport vërehet se procedurat e prokurimit nuk janë respektuar në përpikëri, kjo në fakt lënë hapësirë për dyshime në keqpërdorim. Çështja e zgjedhjes së menaxhmentit, kjo në fakt është neglizhencë e Qeverisë, po edhe e Kuvendit, po që reflekton në punën e vet institucionit.

Raif Preteni, sqaroi procedurat se si ka ardhur deri te zgjedhja e drejtorit të ri ARRU-së, pse është dhënë ky opinion për PVF-të etj. Mungesa e licencave për kompanitë operuese dhe në mënyrë të logjikshme ka rënë inkasimi i të hyrave.

Synavere Rysha, lidhur me rritjen e pagave në ZRRUK tha a është kjo si rezultat i vendimit të Qeverisë për rritje pagash apo Zyra ka bërë rritje pa ndonjë aprovim paraprak? Pyetje për Auditorët?

Ibrahim Gylderen tha se nuk ka çështje për paga, problemi është në kalkulim të mëdijëve për udhëtim të zyrtarëve jashtë vendit.

Faton Topalli tha se nëse nuk ka të interesuar për të diskutuar propozojë të shkojmë me rekomandime.

Përfundim

KMFP, vendosi që raporti i auditimit të PVF-ve të ZRRUK-së të mos adresohet për seancë plenare, megjithatë përkrahën rekomandimet e ZKA-së, të dhëna me rastin e hartimit të raportit të auditimit. Me këtë i jepet afat kohor prej 3 muajve që të përgatitët planin i veprimit me hapa konkret dhe të njëjtin ta dorëzojnë në KMFP. Po ashtu KMFP, ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për vonesat në Përzgjedhjen e Anëtarëve të Bordit të ZRRUK-së.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të performancës Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore

Faton Topalli, kryetar, theksoi se në këtë pikë kemi të bëjmë me Shqyrtimin e Raportit të Auditimit të performancës për Menaxhimin e procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore, me këtë e hapi diskutimin.

Arsim Bajrami, theksoi se ky proces i pajisjeve të nxënësve me teste shkollore është lejuar me ligjin për arsimin parauniversitar, ku nxënësve jemi të obliguar të ju sigurojmë tekste shkollore falas. Në bazë të udhëzimit për shpërndarje të testeve shkollore, ne bëjmë edhe shpërndarjen e tyre. Pra, MASHT udhëheq procesin, ndërsa përfitues janë komunat. Po ashtu Ministri sqaroi hapat që janë ndërmarrë për t'i adresuar të gjitha të metat që ishin me udhëzimin administrativ. Problem në vete për këtë kanë paraqitur stoqet e Librave. Si dhe kthimi i Librave. Në Qeveri është projektligji për testet shkollore, ku me këtë kërkohet t'i jepet MASHT autorësia e testeve shkollore, si dhe mundësia e kursimeve, përmes futjes në përdorim të Librit Digjital.

Artan Venhari shtoi se ky raport i Auditimit në vete paraqet gjendjen reale të furnizimit me libra shkollorë, në kontest të menaxhimit të procesit, kontrollit të tij, si dhe monitorimit. Udhëzimi Administrativ ishte shumë konfuz, është mirë që ky udhëzim po ndryshohet.

Mirlinda Ahmeti tha se ky raport nuk jep rekomandime vetëm për MASHT-in, rekomandimet kanë të bëjnë edhe me nivelin komunal si DAK-ja, si dhe Drejtoritë e Shkollave. Në raportin tonë janë analizuar 3 komuna dhe 9 shkolla.

Abdyl Ymeri tha se projekti për dhënien e librave flas është një hap i mirë i Qeverisë. Në raport të Auditimit për menaxhim të procesit vërehet se ka pasur lëshime. Kjo për shkak të një menaxhimi jo të mirë nga ana e MASHT-it. Disa shkolla thuhet nuk kanë njohuri lidhur me udhëzimin administrativ për shpërndarjen testeve shkollore. Mos kthimi i Librave paraqet shpenzime shtesë. Planifikimi jo i mirë i buxhetit në fillim të vitit, në krahasim me shpenzimin në fund të vitit.

Ali Sadriu tha se përveç ndryshimit të udhëzimit administrativ, duhet të keni kujdes me numrin e nxënësve në komuna. Kjo do të ndikonte në zvogëlimin e shpenzimeve për Blerjen e Librave.

Synavere Rysha shtoi se problem në vete është mos kthimi i librave, dhe kjo ndikon në rritjen e shpenzimeve, me intereson se çka ka ndërmarrë MASHT në këtë drejtim?

Faton Topalli tha se ky raport është një pasqyrë reale për gjendjen në terren, në kontest të furnizimit me libra për nxënësit e Shkollave të Mesme dhe fillore. Këtu nuk është problem udhëzimi administrativ, problem në vete është menaxhimi i tërë procesit nga ana e MASHT-it

dhe komunave në përgjithësi. Pyeti sa është numri i teksteve të dëmtuara dhe sa është shuma e mjeteve që prindërit kanë paguar për tekstet e dëmtuara? Pse mungojnë mekanizmat për dhënien e përgjegjësisë? Me sa kam kuptuar MASHT nuk ka ndonjë depo për pranimin dhe me pastaj shpërndarjen e librave?

Hajdar Beqa theksoi se në tërë këtë projekt bëhet fjalë për furnizim me libra prej 275,000 nxënësve, duke pasur parasysh se gjendja ekonomike nuk është e mirë, kjo në fakt e ka lehtësuar jetën e prindërve në vend. Mendoj se me udhëzim administrativ për shpërndarjen e Librave tekstet shkollore jepen falas, dhe MASHT nuk ka mundur t'i obligojë nxënësit t'i kthejnë ato detyrimisht. Po ashtu pyeti, se cilat janë arsyet e emërimit me vonesë të anëtarëve të Komisionit për ndarjen e librave?

Faton Topalli pyeti se nëse furnizimi me libra të gjuhës angleze me një vonesë e cila është e paraqitur edhe në raport, a nënkupton kjo se dëmtohet procesi i mësimdhënies nga nxënësit në shkolla, sa i përket gjuhës angleze?

Hajdar Beqa theksoi se të shpërndarja e teksteve, nga familjarët është kuptuar se librat nuk do të kthehen, ndërsa në këtë po themi pse MASHT nuk i ka obliguar shkollat të bëjnë grumbullimin e teksteve të vjetra. Besoj se me ndryshimin e udhëzimit administrativ për shpërndarjen e teksteve do të eliminohen këto parregullsi.

Arsim Bajrami, individualisht ju është përgjigjur pyetjeve të deputetëve, si dhe ka siguruar se të gjitha çështjet e ngritura, do të adresohen në planin e veprimit i cili do të dorëzohet në KMFP në momentin kur kjo e fundit do të kërkojë.

Faton Topalli tha se kërkoj nga deputetë të propozojnë rekomandime konkrete, dhe që raporti të mos adresohet për seancë plenare, por rekomandimet të adresohen vetëm për Organizatën Buxhetore.

Përfundim

KMFP vendosi që MASHT në afatin kohor brenda tre muajve të përgatiti planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit. Po ashtu KMFP, vendosi të shtohet një rekomandim i ri që MASHT-ë, të rritë cilësinë e teksteve shkollore, t'i obligojë shkollat që t'i kthejnë tekstet shkollore, dhe të aplikojë masa ndëshkuese për shkollat që nuk e bëjnë kthimin e teksteve shkollore. Këto të përfshihen në udhëzimin e ri administrativ për shpërndarjen e teksteve shkollore.

5. Të Ndryshme

Temat e tjera të parapara për këtë takim kanë mbetur të diskutohen në takimin e radhës së KMFP-së.

Takimi përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli

